

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** , në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar kolegj, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit, “[C...]“ sh.p.k, - , të cilën e përfaqëson me autorizim [S.K], avokat nga Lipjani, kundër të paditurës Republika e Kosovës- Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Infrastrukturës – Drejtoria e Rrugëve me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Ilire Eydogan, avokate Publike për shkak të pagesës së borxhit në shumë të përgjithshme prej 20,880.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr. 342/2015, të datës 18.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt. 02.04.2019, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e të paditurës Republika e Kosovës- Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Infrastrukturës – Drejtoria e Rrugëve me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore – Departamenti për Çështje Ekonomike, I.C.nr.342/2015, të datës 18.10.2017 , **VËRTETOHET** .

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka miratuar kërkesëpadinë e paditësit “[C...]“, me seli në Lipjan, ashtu që detyrohet i padituri Republika e Kosovës- Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, që në emër të pasurimit të pabaze juridike, t’ia paguajë shumën prej 20,880.00€, me kamatë të njëjtë siç e aplikojnë bankat të cilat operojnë në Kosovë, me rastin e deponimit të mjeteve në bankë, në afatin prej një viti, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedhe nga data e parashtrimit të padisë në gjykatë, data 11.08.2015, e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit ëshët detyruar i padituri që paditëses t’ia paguajë shumën prej 853.20€, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afatin prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, duke propozuar që Gjykata e Apelit aktgjykimin e goditur me këtë ankesë ta ndryshojë ose të njëjtin ta kthejë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar Paditësi duke i propozuar Gjykatës se Apelit që ankesën e palës së paditur ta refuzojë dhe aktgjykimin I.C.342/2015, të datës 18.10.2017 ta vërtetojë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK , gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se, paditësi “[C...]” sh.p.k, -Terminali për Distribuimin e Cementës Refuze me datën 11.08.2015, ka ushtruar padi pranë gjykatës së shkallës së parë, kundër të paditurit Republika e Kosovës –Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Infrastrukturës, me seli në Prishtinë, për kthimin e borxhit.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e lëndës, ka konstatuar se paditësi me qëllim të zhvillimit të veprimtarisë së tij afariste, ka bërë kërkesë te i padituri, për te marrë pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike- brezit rrugor, në magjistralen M25, drejtimi Prizren-Prishtinë. Komisioni i formuar nga Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit, ka dalë në teren dhe ka kanë bërë matjen e sipërfaqes së brezit rrugor. Sipas këtyre matjeve është dhënë konstatimi nga komisioni se sipërfaqja e tokës publike, të cilën do ta përdor paditësi është 780 m2. Me datën 03.07.2017, paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë për shfrytëzimin e hapësirës publike, në sipërfaqe të cilën e ka konstatuar komisioni i të paditurit, prej 780 m2, me çmimin prej 8.00€, për m2. Paditësi, ka marrë detyrime që në emër të shfrytëzimit të kësaj sipërfaqe t’ia paguaj të paditurit shumën prej 6,240.00€ në vit. Me datën 21.10.2014 paditësi ka parashtruar kërkesë te i padituri, për ri-matjen e hapësirës të përcaktuar në kontratë. Pas matjeve të kryera dhe evidentimit të gabimit në matje, me datën 21.10.2014, i padituri ka nxjerre vendim me të cilin e ka ndryshuar sipërfaqen e hapësirës publike të cilën e shfrytëzon paditësi, nga 780 m2 në 380 m2, e rrjedhimisht ka ndryshuar edhe çmimi i përgjithshëm nga 6,240.00€, në 3,040€ në vit. Paditësi ka parashtruar se është varfëruar pa bazë juridike si rezultat i gabimit të cilin e ka bërë komisioni i të paditurës. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se paditësi ka bërë pagesën për periudhën prej viti 2007 deri në vitin 2013, në shumën e përgjithshme prej 43,680.00€, ndërsa pas ri-matjes dhe duke ju referuar vendimit të palës së paditur, ka gjetur se paditësi është dashur të kryej pagesa në shumën prej 3,040.00€ në vit, ku për vitet 2007-2013 është dashur të paguajë shumën prej 21,280.00€. Pas konstatimit të tillë duke u bazuar në dispozitën e Nenit 210 të LMD-së, gjykata e shkallës së parë ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale sepse dispozitat e nenit 210 të LMD-së (1978), i aplikueshëm në rastin konkret, respektivisht Neni 194 i LIGJI NR. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktojnë se: secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga

tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur, përfshirë edhe përvetësimin e fitimit përmes shërbimeve, apo pranimin e diçkaje në lidhje me një bazë që nuk është realizuar ose më pas zhduket.

Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur ka vendosur që paditësit t'i kthehet shuma e paguar në emër të fitimit të pabazë në shumën prej 20,880.00€, sepse gabimi në matjen e sipërfaqes publike të cilën e ka shfrytëzuar paditësi është bërë nga Komisioni i formuar nga Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit r ashtu qe nga siperfaqja prej 780 m2 per të cilën paditësi ka paguar çmimin e shfrytëzimit, rezulton se është 380 m2, e me këtë ka ndryshuar edhe çmimi i përgjithshme nga 6,240.00€, në 3,040€ në vit. Prandaj mbajtja e asaj pagese, mbi shumën reale të detyrimit të cilën është dashur ta paguaj paditësi, përbën pasurim të pabazë të së paditurës në dëm të paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 8, par. 1 dhe par. 2, të LPK-së. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Prandaj sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, ku e ka vlerësuar si të pabazuar pretendimin e të paditurës në lidhje me zbatimin e të drejtës materiale, ku gjykata në mënyrë të drejte ka zbatuar dispozitën e nenit 210 të LMD-së, që ka qene në fuqi në krijimin e marrëdhënies juridike.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërrthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS ,**

**Ae.nr.269/2017, dt. 02.04.2019**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**

**Mahir Tutull, d.v.**

